



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

NIVELET E ARRITJES SË KOMPETENCAVE TË FUSHAVE TË TË NXËNIT
ARSIMI FILLOR

KLASA I-III DHE IV-V

Tiranë
Mars, 2019



TABELA E PËRMBAJTJES

TABELA E PËRMBAJTJES.....	2
LISTA E TABELAVE.....	4
1 HYRJE.....	5
2 KËRKESA PËR ZBATIMIN E NIVELEVE TË ARRITJES.....	6
3 PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM I NIVELEVE TË ARRITJES	7
4 NIVELET E ARRITJES SË KOMPETENCAVE NË FUSHËN “GJUHËT DHE KOMUNIKIMI”	9
4.1 Lënda: Gjuhë Shqipe.....	9
4.2 Lënda: Gjuhë e huaj	20
5 NIVELET E ARRITJES SË KOMPETENCAVE NË FUSHËN “ MATEMATIKË”	25
6 NIVELET E ARRITJES SË KOMPETENCAVE NË FUSHËN “SHKENCAT E NATYRËS”.....	38
6.1 Lënda “Dituri natyre”.....	38
7 NIVELET E ARRITJES SË KOMPETENCAVE NË FUSHËN “ SHOQËRIA DHE MJEDISI”	44
7.1 Lënda: Histori.....	44
7.2 Lënda: Edukim për shoqërinë/ Qytetari	48
8 NIVELET E ARRITJES SË KOMPETENCAVE NË FUSHËN “ TIK DHE TEKNOLOGJI”	64
8.1 Lënda: TIK	64
8.2 Lënda: Aftësim teknologjik.....	71

9	NIVELET E ARRITJES SË KOMPETENCAVE NË FUSHËN “ARTE”	79
9.1	Lënda: Muzika.....	79
9.2	Lënda “Art pamor”	86
9.3	Lënda “Kërcim”	93
10	NIVELET E ARRITJES SË KOMPETENCAVE NË FUSHËN “ EDUKIMI FIZIK, SPORTET DHE SHËNDETI”.....	99

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Nivelet e arritjes së kompetencave dhe përshkrimi i tyre	8
Tabela 2.....	9
Tabela 3.....	15
Tabela 4.....	20
Tabela 5.....	21
Tabela 6.....	25
Tabela 7.....	31
Tabela 8.....	38
Tabela 9.....	41
Tabela 10.....	44
Tabela 11.....	48
Tabela 12.....	64
Tabela 13.....	71
Tabela 14.....	79
Tabela 15.....	83
Tabela 16.....	86
Tabela 17.....	90
Tabela 18.....	93
Tabela 19.....	99
Tabela 20.....	103

1 HYRJE

Vlerësimi në arsim është procesi gjatë të cilit mblidhen të dhëna dhe gjykohet për vlerën e arritjes së rezultatit të të nxënit, mbi bazën e një kriteri të caktuar. Qëllimi kryesor i vlerësimit është marrja e vendimeve që synojnë përmirësimin e rezultateve të të nxënit dhe vetë procesin e tij. Marrja e vendimeve kërkon grumbullimin e vazhdueshëm të informacionit për të matur dhe për të vlerësuar të gjitha aspektet e procesit. Vlerësimi është pjesë integrale e të nxënit, mësimdhënies dhe programit mësimor dhe kjo sjell që qasja e sigurimit të cilësisë, të zbatohet në mënyrë të barabartë gjatë vlerësimit.

Nivelet e arritjes shprehin kritere të njësuara për vlerësimin e njohurive, të shkathtësive dhe qëndrimeve të nxënësve sipas fushave përkatëse. Këto nivele hartohen për të mundësuar mësuesit, që të përcaktojnë arritjen e kompetencës nga nxënësi në fund të klasës së tretë dhe të pestë.

Vlerësimi rigoroz, bazuar në nivele të përcaktuara, krijon besim për vlerësimet e mësuesve, jep siguri te prindërit që të gjithë nxënësit i kanë arritjet e tyre në përputhje me pritshmëritë.

2 KËRKESA PËR ZBATIMIN E NIVELEVE TË ARRITJES

Nivelet e arritjes bazohen në rezultatet e të nxënimit të kompetencave të përcaktuara për fushat/lëndët përkatëse në dokumentin e kurrikulës bërthamë. Ato përdoren nga mësuesit, hartuesit e teksteve shkollore e materialeve të tjera ndihmëse, specialistët e vlerësimit dhe specialistët e arsimit.

Në veçanti, nivelet e arritjes ndihmojnë mësuesin për të planifikuar mësimdhënien individuale, punën e diferencuar sipas nivelit të nxënësit, për të ndikuar pozitivisht në progresin e tij dhe për të raportuar të nxënimit e nxënësit. Për të përcaktuar nivelin e arritjes së nxënësit duhen bërë një sërë vëzhgimesh dhe duhen përdorur një sërë instrumentesh vlerësimi, të cilat do të shërbejnë më pas për progresin e tij.

Hartimi i instrumenteve të vlerësimit të arritjeve të të nxënimit duhet kryer duke u mbështetur në nivelet e arritjeve që janë përshkruar në këtë dokument.

3 PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM I NIVELEVE TË ARRITJES

Vlerësimi i nxënësit në klasat I-III për arritjen e kompetencave të fushave të të nxënimit bëhet me përshkrim. Ai realizohet me *5 nivelet e arritjes së kompetencave* si më poshtë:

- *Niveli 1. “Arritje të pakënaqshme”*, kur nxënësi nuk përmbush kërkesat bazë të të nxënimit.
- *Niveli 2. “Arritje që kanë nevojë për përmirësim”*, kur nxënësi ka arritur vetëm pak nga kërkesat bazë të të nxënimit dhe kërkohet mbështetje dhe punë e vazhdueshme nga ana e tij dhe e mësuesit.
- *Niveli 3. “Arritje të kënaqshme”*, kur nxënësi ka përmbushur kërkesat bazë të të nxënimit dhe, kur me mbështetjen e mësuesit, arrin të përparojë.
- *Niveli 4. “Arritje shumë të kënaqshme”*, kur nxënësi ka përmbushur pjesën më të madhe të kërkesave të të nxënimit.
- *Niveli 5. “Arritje të shkëlqyera”*, kur nxënësi përmbush plotësisht dhe me cilësi kërkesat e të nxënimit të programit lëndor.

Vlerësimi i nxënësit në klasat IV dhe V bëhet me notat 4-10. Nga klasa e katërt deri në klasën e dymbëdhjetë, janë përcaktuar **katër nivele arritjeje**¹ të njohurive, aftësive dhe qëndrimeve që demonstroi nxënësi:

- niveli I (*pamjaftueshëm, nota 4*), kur nxënësi nuk përmbush kërkesat bazë të të nxënimit;
- niveli II (*mjaftueshëm, notat 5-6*), kur nxënësi ka arritur disa nga kërkesat bazë të të nxënimit dhe kërkohet mbështetje dhe punë e vazhdueshme nga ana e tij për të përparuar;
- niveli III (*mirë, notat 7-8*), kur nxënësi ka përmbushur një pjesë të konsiderueshme të kërkesave bazë të të nxënimit dhe, kur me mbështetjen e mësuesit, vazhdon të përparojë;
- niveli IV (*shumë mirë, notat 9-10*), kur nxënësi përmbush plotësisht dhe me cilësi kërkesat e të nxënimit të programit lëndor.

¹ Në klasat IV-V janë përcaktuar **katër nivele arritjeje** pasi në këtë grupmoshë fillon të rritet pesha e njohurive dhe e formimit akademik në vlerësimin e nxënësit dhe vlerësimi nuk bazohet më në **kriterin e normës**.

Tabela 1. Nivelet e arritjes së kompetencave dhe përshkrimi i tyre

NIVELI I (Notat 4)	NIVELI II (Notat 5-6)	NIVELI III (Notat 7-8)	NIVELI IV (Nota 9-10)
Nxënësit në këtë nivel demonstrojnë një shkallë të pamjaftueshme të zotërimit dhe zbatimit të njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve.	Nxënësit në këtë nivel zotërojnë njohuri, aftësi dhe qëndrime dhe i zbatojnë ato në situata të përcaktuara/të njohura; ata kryejnë detyra lëndore sipas modeleve të ofruara.	Nxënësit në këtë nivel zotërojnë njohuri, aftësi dhe qëndrime dhe i zbatojnë ato në situata analoge ose të ngjashme; ata shprehin qëndrimin e tyre personal, duke vepruar më shumë në nivelin e pohimeve dhe konkluzioneve të formuluar se sa në nivel analize.	Nxënësit në këtë nivel zotërojnë njohuri, aftësi, qëndrime dhe i zbatojnë ato në mënyrë të pavarur dhe krijuese, në situata të reja dhe të panjohura për ta; ata janë të aftë të zgjidhin situata problemore të ndryshme, të mbrojnë pikëpamjet dhe qëndrimet e tyre bazuar në argumente.

Në vëmendje të mësuesit: Qëllimi i kurrikulës së re është të realizojë zhvillimin e plotë të potencialit të çdo nxënësi, duke u mbështetur te anët dhe cilësitë e tij më të forta për të kapërcyer pengesat dhe vështirësitë në të nxënë. Në të gjitha fushat e të nxënit/ lëndët, nuk do të përmendet Niveli 1, sepse qëllimi i shkollës është që çdo nxënës të arrijë sukses në shkollë.

4 NIVELET E ARRITJES SË KOMPETENCAVE NË FUSHËN “GJUHËT DHE KOMUNIKIMI”

4.1 Lënda: Gjuhë Shqipe

Tabela 2

KLASAT I-III			
Kompetenca “Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme”			
Përshkrimi i kompetencës			
<p>Nxënësi merr njohuri, zhvillon qëndrime dhe vlera, si dhe zbaton aftësi dhe shkathtësi duke dëgjuar tekste të ndryshme. Më konkretisht, nxënësi kupton se sjellja dhe qëndrimet e duhura gjatë të dëgjuarit ndikojnë pozitivisht te të tjerët. Nxënësi tregon brendinë, veçon idenë kryesore, dallon fjalët ose frazat kyçe, si dhe bën vlerësime të thjeshta për tekstet që dëgjon.</p>			
Niveli 2	Niveli 3	Niveli 4	Niveli 5
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>u përgjigjet pyetjeve të mësuesit rreth përmbajtjes së një bisede, poezie, përralle, tregimi, udhëzimi etj.</i> • <i>me ndihmën e mësuesit, lidh njohuritë paraprake me ato të tekstit që dëgjon.</i> 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>tregon me fjalët e tij përmbajtjen e një bisede, poezie, përralle, tregimi, udhëzimi etj.;</i> • <i>me ndihmën e mësuesit, dallon ngjarjet ose informacionin kryesor, si dhe lidh njohuritë paraprake me ato të tekstit që dëgjon.</i> 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>tregon me fjalët e tij përmbajtjen e një bisede, poezie, përralle, tregimi, udhëzimi etj.;</i> • <i>në përgjithësi, dallon ngjarjet ose informacion kryesor;</i> • <i>lidh njohuritë paraprake me ato të tekstit që dëgjon, si dhe jep disa gjykime të thjeshta rreth këtij teksti.</i> 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>tregon përmbajtjen e një bisede, poezie, përralle, tregimi, udhëzimi etj.;</i> • <i>dallon lehtësisht, ngjarjet ose informacionin kryesor;</i> • <i>lidh njohuritë paraprake me ato të tekstit që dëgjon, si dhe jep gjykimet e tij rreth këtij teksti.</i>

Kompetenca “Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar”

Përshkrimi i kompetencës

Nxënësi shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët dhe fjalitë, me qëllim që të jetë i kuptueshëm për të tjerët, flet për tema të thjeshta dhe bashkëbisedon me të tjerët. Ai shoqëron të folurin edhe me elemente të komunikimit jo verbal dhe diskuton dhe bashkëvepron me të tjerët gjatë punës në grup.

Niveli 2	Niveli 3	Niveli 4	Niveli 5
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>flet mjaftueshëm rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur, si dhe tregon me ndihmën e mësuesit, një ngjarje, një përrallë, një përvojë të tijën etj.;</i> • <i>qëndron indiferent gjatë diskutimeve në grupe të vogla për tema të ndryshme dhe përfshihet në to me nxitjen e mësuesit;</i> • <i>përfshihet me nxitjen e</i> 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>përpiqet të flasë rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur, si dhe tregon në mënyrë të kuptueshme një ngjarje, një përvojë të tijën etj.;</i> • <i>përfshihet në diskutime në grupe të vogla për tema të ndryshme, por nuk është shumë aktiv në to;</i> • <i>merr pjesë në përgatitjen e materialeve për organizimin e shfaqjeve dhe ekspozitave në klasë;</i> 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>në përgjithësi, flet rrjedhshëm, kuptueshëm dhe me intonacionin e duhur, kur tregon një ngjarje ose një përvojë të tijën, kur përshkruan diçka etj.;</i> • <i>aktivizohet në diskutime në grupe të vogla për tema të ndryshme;</i> • <i>merr pjesë në përgatitjen e materialeve për organizimin e shfaqjeve dhe ekspozitave në klasë;</i> • <i>merr pjesë në lojë me role.</i> 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>flet gjithmonë rrjedhshëm, kuptueshëm dhe me intonacionin e duhur, kur tregon një ngjarje ose një përvojë të tijën, kur përshkruan diçka etj.;</i> • <i>është aktiv gjatë diskutimeve në grupe të vogla për tema të ndryshme, si dhe bën pyetje dhe jep përgjigje në këto diskutime;</i> • <i>përgatit materiale për organizimin e shfaqjeve dhe ekspozitave në klasë;</i>

<p><i>mësuesit në përgatitjen e materialeve për organizimin e shfaqjeve në klasë;</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <i>merr pjesë në lojë me role.</i> 	<ul style="list-style-type: none"> <i>merr pjesë në lojë me role.</i> 		<ul style="list-style-type: none"> <i>merr pjesë në mënyrë aktive, në lojë me role.</i>
--	--	--	--

Kompetenca “Të lexuarit e teksteve letrare dhe jo letrare”

Përshkrimi i kompetencës

Nxënësi lexon tekste letrare dhe jo letrare të ndryshme dhe demonstroi kuptimin, interpretimin, analizën, vlerësimin dhe gjykimin e këtyre teksteve (të përshtatshme për zhvillimin moshor të nxënësit).

Niveli 2	Niveli 3	Niveli 4	Niveli 5
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <i>lexon mjaftueshëm rrjedhshëm tekste të thjeshta, si dhe dallon fjalën, fjalinë dhe paragrafin;</i> <i>tregon nëpërmjet pyetjeve të mësuesit, brendinë e tekstit dhe dallon disa nga pjesët plotësuese të tij (p.sh.: foto, vizatim, pamje etj.).</i> 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <i>lexon rrjedhshëm tekste të thjeshta, si dhe dallon fjalën, fjalinë dhe paragrafin;</i> <i>tregon mirë brendinë e tekstit dhe dallon pjesët plotësuese të tij (p.sh., foto, vizatim, pamje etj.);</i> <i>shpreh me ndihmën e mësuesit, përshtypjet ose përjetimet e veta në lidhje me</i> 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <i>lexon në përgjithësi, rrjedhshëm dhe me shprehësi tekste të thjeshta, si dhe dallon fjalën, fjalinë dhe paragrafin;</i> <i>tregon brendinë duke respektuar në përgjithësi, strukturën e tekstit, si dhe tregon funksionin e pjesëve plotësuese të tij (p.sh.: foto, vizatim, pamje etj.);</i> <i>shpreh përshtypjet ose</i> 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <i>lexon rrjedhshëm dhe me shprehësi tekste të thjeshta, si dhe dallon lehtësisht fjalën, fjalinë dhe paragrafin;</i> <i>tregon brendinë duke respektuar strukturën e tekstit, si dhe tregon funksionin e pjesëve plotësuese të tij (p.sh., foto, vizatim, pamje etj.);</i> <i>shpreh përshtypjet ose</i>

	<p>një tekst të shkurtër letrar (poezi, përralla nga folklori, përralla nga autorë të ndryshëm, tregime, fabula) dhe jo letrar (ditar, fjalorë të thjeshtë, udhëzime).</p>	<p><i>përjetimet e veta</i> në lidhje me një tekst të shkurtër letrar (poezi, përralla nga folklori, përralla nga autorë të ndryshëm, tregime, fabula) dhe jo letrar (ditar, fjalorë të thjeshtë, udhëzime).</p>	<p><i>përjetimet e veta</i> në lidhje me një tekst të shkurtër letrar (poezi, përralla nga folklori, përralla nga autorë të ndryshëm, tregime, fabula) dhe jo letrar (ditar, fjalorë të thjeshtë, udhëzime).</p>
--	--	--	--

Kompetenca “Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale”

Përshkrimi i kompetencës

Nxënësi shkruan për qëllime dhe lexues të ndryshëm. Ai ndjek gjatë të shkruarit hapa si: planifikimi, organizimi i ideve, rishikimi dhe redaktimi. Nxënësi, gjithashtu, respekton strukturën, tiparet e tekstit, si dhe rregullat gjuhësore.

Niveli 2	Niveli 3	Niveli 4	Niveli 5
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> shpreh me gjuhë të varfër dhe me ndihmën e mësuesit, përjetimet e tij rreth një ngjarjeje, libri, përralle, personazhi etj.; shkruan tekste të thjeshta (urim, letër, kartolinë etj.) sipas modeleve të dhëna. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> shpreh me gjuhë të thjeshtë përjetimet e tij rreth një ngjarjeje, libri, përralle, personazhi etj.; shkruan tekste të thjeshta (urim, letër, kartolinë etj.) sipas modeleve të dhëna. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> shpreh në përgjithësi, qartë dhe pa gabime drejtshkrimore përjetimet e tij rreth një ngjarjeje, libri, përralle, personazhi etj.; shkruan tekste të thjeshta (urim, letër, kartolinë etj.) duke respektuar në përgjithësi, 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> shpreh qartë dhe pa gabime drejtshkrimore përjetimet e tij rreth një ngjarjeje, libri, përralle, personazhi etj.; shkruan tekste të thjeshta (urim, letër, kartolinë etj.) duke respektuar strukturën dhe karakteristikat e tyre.

strukturën dhe karakteristikat kryesore të tyre.

Kompetenca “Përdorimi i drejtë i gjuhës”

Përshkrimi i kompetencës

Që nxënësi të flasë dhe të shkruajë në mënyrën e duhur, atëherë ai duhet të zotërojë njohuri e të demonstrojë shkathtësi, vlera dhe qëndrime në lidhje me sistemin gjuhësor të gjuhës shqipe. Kështu, nxënësi dallon pjesët e ndryshme të ligjëratës, kategoritë e tyre gramatikore dhe i përdor në trajtën e duhur gjatë komunikimit; dallon llojet e ndryshme të fjalive dhe funksionet e fjalëve në fjali dhe i zbaton këto njohuri në komunikimin e përditshëm; dallon kuptimet e fjalëve dhe i përdor për të pasuruar fjalorin e tij.

Niveli 2	Niveli 3	Niveli 4	Niveli 5
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> dallon me ndihmën e mësuesit, fjalitë e thjeshta dëftore dhe pyetëse; dallon me vështirësi emra njerëzish, sendesh dhe kafshësh në numrin njëjës dhe shumës (përgjithësisht emra që janë të njohur); zgjedhon me ndihmën e mësuesit, folje të rregullta 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> dallon fjalitë e thjeshta dëftore dhe pyetëse; dallon emra njerëzish, sendesh dhe kafshësh në numrin njëjës dhe shumës; zgjedhon folje të rregullta në kohën e tashme sipas modeleve të dhëna; dallon mbiemrin si fjalë që tregojnë cilësi të emrit; 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> dallon dhe formon në përgjithësi, fjali të thjeshta dëftore dhe pyetëse, duke respektuar shenjat e pikësimit; dallon emra njerëzish, sendesh dhe kafshësh në numrin njëjës dhe shumës dhe, në përgjithësi, i shkruan drejt ato; zgjedhon folje të rregullta në kohën e tashme sipas modeleve 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> dallon dhe formon me lehtësi fjali të thjeshta dëftore dhe pyetëse, duke respektuar shenjat e pikësimit; dallon emra njerëzish, sendesh dhe kafshësh në numrin njëjës dhe shumës dhe i shkruan drejt ato; zgjedhon folje të rregullta në kohën e tashme dhe formon

<p>në kohën e tashme sipas modeleve të dhëna.</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>dallon me ndihmën e mësuesit</i>, mbiemrin si fjalë, që tregon cilësi të emrit; • <i>gjen</i> përemrat vetorë dhe numërorët. 	<ul style="list-style-type: none"> • <i>gjen</i> përemrat vetorë dhe numërorët. 	<p><i>të dhëna</i> dhe formon fjali duke përdorur formën e drejtë;</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>dallon</i> mbiemrin si fjalë që tregon cilësi të emrit, si dhe <i>formon</i> fjali me të ose e shton në fjali të dhëna; • <i>gjen</i> përemrat vetorë dhe numërorët. 	<p><i>fjali duke përdorur formën e drejtë të tyre</i>;</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>dallon</i> mbiemrin si fjalë që tregon cilësi të emrit, <i>si dhe formon fjali me të ose e shton në fjali të dhëna</i>; • <i>gjen dhe formon</i> fjali me përemra vetorë dhe me numërorë.
--	--	---	--

Tabela 3

KLASAT IV -V		
Kompetenca “Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme”		
<i>Përshkrimi i kompetencës</i>		
<p>Nxënësi merr njohuri, zhvillon qëndrime dhe vlera, si dhe zbaton aftësi dhe shkathtësi duke dëgjuar tekste të ndryshme.</p> <p>Më konkretisht, nxënësi kupton se sjellja dhe qëndrimet e duhura gjatë të dëgjuarit ndikojnë pozitivisht te të tjerët. Ai dallon disa cilësi të zërit të folësit si: intonacioni, ritmi, theksi, volumi i zërit. Gjithashtu, nxënësi tregon brendinë, veçon idenë kryesore, dallon fjalët ose frazat kyçe, bën konkluzione, krahason ose klasifikon, si dhe bën vlerësime të thjeshta për tekstet që dëgjon.</p>		
Niveli 2	Niveli 3	Niveli 4
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • u përgjigjet pyetjeve dhe tregon shkurtimisht përmbajtjen e tekstit; • me ndihmën e mësuesit, lidh njohuritë e mëparshme me ato të tekstit; • me ndihmën e mësuesit veçon informacionin kryesor dhe jep disa gjykime të thjeshta për përmbajtjen e tekstit. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • u përgjigjet pyetjeve, tregon me fjalët e tij përmbajtjen e tekstit, si dhe lidh njohuritë e mëparshme me ato të tekstit; • diskuton rreth informacionit kryesor, përmbledh dhe jep disa gjykime të thjeshta për përmbajtjen e tekstit. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • dëgjon me vëmendje në situata dhe për qëllime të ndryshme dhe u përgjigjet pyetjeve, tregon përmbajtjen që dëgjon duke e ilustruar me shembuj dhe ilustrime nga teksti, lidh dhe krahason me lehtësi njohuritë e mëparshme me ato të tekstit; • diskuton rreth informacionit kryesor, përmbledh dhe gjykon përmbajtjen dhe qëllimin e tekstit.

Kompetenca “Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar”

Përshkrimi i kompetencës

Nxënësi përdor gjuhën standarde gjatë të folurit, kupton dhe zbaton në komunikim karakteristikat e gjuhës së folur, shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët dhe fjalitë, me qëllim që të jetë i kuptueshëm dhe interesant për të tjerët. Ai shoqëron të folurin edhe me elemente të komunikimit jo verbal dhe diskuton dhe bashkëvepron me të tjerët gjatë punës në grup.

Niveli 2	Niveli 3	Niveli 4
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none">shpreh me një gjuhë të varfër dhe shkurtimisht, idetë, ndjenjat ose përjetimet e tij;është i tërhequr në diskutime dhe bashkëbisedime dhe përfshihet në to me nxitjen e mësuesit;është i tërhequr në përgatitjen e materialeve për organizimin e shfaqjeve dhe aktiviteteve në klasë dhe në shkollë dhe përfshihet në to me nxitjen e mësuesit;merr pjesë në lojërat e thjeshta skenike.	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none">përpiqet të përzgjedhë fjalët dhe shprehjet e duhura, kur shpreh idetë, ndjenjat ose përjetimet e tij;merr pjesë në diskutime dhe bashkëbisedime;përfshihet në bashkëpunim me të tjerët për përgatitjen e materialeve për organizimin e shfaqjeve dhe aktiviteteve në klasë dhe në shkollë;merr pjesë në lojërat e thjeshta skenike.	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none">flet qartë, rrjedhshëm dhe përzgjedh fjalët dhe shprehjet e duhura, kur shpreh idetë, ndjenjat ose përjetimet e tij;merr pjesë aktive në diskutime dhe bashkëbisedime me pyetje, gjykime, komente apo sqarime;përgatit materiale për organizimin e shfaqjeve dhe aktiviteteve në klasë dhe në shkollë;shfaq prirje në lojërat e thjeshta skenike.

Kompetenca “Të lexuarit e teksteve letrare dhe jo letrare”

Përshkrimi i kompetencës

Nxënësi lexon tekste letrare dhe jo letrare që u përkasin periudhave të ndryshme, tekste klasike dhe bashkëkohore, shqipe dhe botërore dhe demonstroi kuptimin, interpretimin, analizën, vlerësimin dhe gjykimin e këtyre teksteve (të përshtatshme për zhvillimin moshor të nxënësit).

Niveli 2	Niveli 3	Niveli 4
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • lexon <i>mjaftueshëm</i> rrjedhshëm tekste të cilat janë të përshtatshme për moshën e tij; • <i>tregon</i> brendinë e tekstit; • <i>përcakton me ndihmën e mësuesit</i>, temën dhe idetë kryesore në tekste letrare si: poezi, këngë popullore, poema, fabula, tregime, novela, legjenda, përralla, mite, romane për fëmijë, drama; • <i>dallon elemente të thjeshta</i> në një tekst si: subjekti, personazhi kryesor, personazhe dytësore, mjedisi ose hapësira ku zhvillohen ngjarjet; • <i>gjen në një tekst</i>: rimën, krahasimin, epitetin; 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • lexon <i>rrjedhshëm</i> tekste të cilat janë të përshtatshme për moshën e tij; • <i>tregon mirë</i> brendinë, si dhe <i>dallon</i> pjesët themelore ose informacionin kryesor të tekstit; • <i>dallon</i> temën dhe idetë kryesore në tekste letrare si: poezi, këngë popullore, poema, fabula, tregime, novela, legjenda, përralla, mite, romane për fëmijë, drama; • <i>interpretonte elemente të thjeshta</i> në një tekst si: subjekti, personazhi kryesor, personazhe dytësore, mjedisi ose hapësira ku zhvillohen ngjarjet; 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • lexon <i>rrjedhshëm dhe me shprehësi</i> tekste të cilat janë të përshtatshme për moshën e tij; • <i>tregon brendinë duke e ilustruar me shembuj dhe detaje</i> nga teksti, si dhe <i>dallon me lehtësi</i> pjesët themelore ose informacionin kryesor të tekstit; • <i>dallon me lehtësi</i> temën dhe idetë kryesore në tekste letrare si: poezi, këngë popullore, poema, fabula, tregime, novela, legjenda, përralla, mite, romane për fëmijë, drama; • <i>interpretonte dhe analizonte</i> elemente të thjeshta në një tekst si: subjekti, personazhi kryesor, personazhe dytësore, mjedisi ose hapësira ku zhvillohen ngjarjet;

<ul style="list-style-type: none"> dallon me ndihmën e mësuesit, temën, idetë, strukturën dhe elementet grafike të një teksti jo letrar (letër formale, udhëzim, njoftim etj.). 	<ul style="list-style-type: none"> gjen në një tekst: rimën, onomatopenë, personifikimin, krahasimin, hiperbolën, epitetin; dallon temën, idetë, strukturën dhe elementet grafike të teksti jo letrar (letër formale, udhëzim, njoftim etj.). 	<ul style="list-style-type: none"> dallon gjuhën e figurshme nga gjuha jo e figurshme, gjen në një tekst: rimën, onomatopenë, personifikimin, krahasimin, hiperbolën, epitetin, <i>si dhe tregon çfarë funksioni kanë;</i> dallon dhe analizon temën, idetë, strukturën dhe elementet grafike të teksti jo letrar (letër formale, udhëzim, njoftim etj.).
---	---	---

Kompetenca “Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale”

Përshkrimi i kompetencës

Nxënësi shkruan për qëllime dhe lexues të ndryshëm. Ai ndjek gjatë të shkruarit hapa si: planifikimi, organizimi i ideve, rishikimi dhe redaktimi. Nxënësi, gjithashtu, respekton strukturën, tiparet e tekstit, si dhe rregullat gjuhësore.

Niveli 2	Niveli 3	Niveli 4
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> shkruan tekste <i>për lexues të njohur;</i> zbaton me vështirësi gjatë të shkruarit, karakteristikat e tekstit, <i>sidomos kur punon</i> me një lloj të ri teksti; ka nevojë për ndihmën dhe nxitjen e mësuesit për të shkruar dhe rishikuar punën ose detyrën me shkrim. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> shkruan <i>duke u përqendruar mirë</i> në temën dhe llojin e tekstit; shkruan tekste të ndryshme <i>duke respektuar strukturën e tyre dhe karakteristikat kryesore;</i> identifikon me ndihmën e mësuesit, në punët e tij elementet që kanë 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> shkruan tekste <i>duke u përqendruar</i> në temën që do të trajtojë <i>duke lidhur logjikisht</i> fjalitë në paragraf dhe paragrafët mes tyre; shkruan për qëllime dhe situata të ndryshme tekste të ndryshme <i>duke respektuar</i> strukturën dhe karakteristikat e tyre; identifikon në punët e tij elementet që kanë

	nevojë për përmirësime si p.sh., përdorimin e gjuhës ose strukturën e tekstit dhe i redakton ato.	nevojë për përmirësime si p.sh., përdorimin e gjuhës ose strukturën e tekstit dhe i redakton ato.
Kompetenca “Përdorimi i drejtë i gjuhës”		
Përshkrimi i kompetencës		
<p>Që nxënësi të flasë dhe të shkruajë në mënyrën e duhur, atëherë ai duhet të zotërojë njohuri e të demonstrojë shkathtësi, vlera dhe qëndrime në lidhje me sistemin gjuhësor të gjuhës shqipe. Kështu, nxënësi dallon pjesët e ndryshme të ligjëratës, kategoritë e tyre gramatikore dhe i përdor në trajtën e duhur gjatë komunikimit; dallon llojet e ndryshme të fjalive dhe funksionet e fjalëve në fjali dhe i zbaton këto njohuri në komunikimin e përditshëm; përdor gjuhën standarde; demonstroi njohuri për mënyrat e formimit të fjalëve në gjuhën shqipe, dallon kuptimet e fjalëve dhe i përdor për të pasuruar fjalorin e tij.</p>		
Niveli 2	Niveli 3	Niveli 4
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>dallon</i> lloje të ndryshme fjalish (dëftore, pyetëse, nxitëse dhe dëshirore); • <i>dallon me ndihmën e mësuesit</i>, gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët e dyta të fjalisë (kundrinor, rrethor, përcaktor); • <i>dallon me ndihmën e mësuesit</i>, kategoritë kryesore gramatikore të 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>dallon dhe përdor në përgjithësi</i>, lloje të ndryshme fjalish (dëftore, pyetëse, nxitëse dhe dëshirore); • <i>dallon dhe përdor në përgjithësi</i>, gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët e dyta të fjalisë (kundrinor, rrethor, përcaktor); • <i>dallon</i> kategoritë kryesore gramatikore të emrit, foljes, 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>dallon, analizon dhe përdor drejt</i> lloje të ndryshme fjalish (dëftore, pyetëse, nxitëse dhe dëshirore), <i>si dhe argumenton përgjigjen e tij</i>; • <i>dallon dhe përdor drejt</i> gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët e dyta të fjalisë (kundrinor, rrethor, përcaktor), <i>si dhe argumenton përgjigjen e tij</i>; • <i>dallon me lehtësi</i> kategoritë kryesore

<p>emrit, foljes, mbiemrit, përemrit;</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>dallon</i> fjalët e parme dhe jo të parme; • <i>dallon</i> sinonimet, antonimet, homonimet. 	<p>mbiemrit, përemrit, si dhe gjen lidhëzat dhe parafjalët;</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>dallon</i> fjalët e parme dhe jo të parme; • <i>dallon</i> sinonimet, antonimet, homonimet, fjalët e urta dhe shprehjet frazeologjike. 	<p>gramatikore të emrit, foljes, mbiemrit, përemrit, si dhe gjen lidhëzat dhe parafjalët, <i>si dhe argumenton përgjigjen e tij</i>;</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>dallon</i> fjalët e parme dhe jo të parme si dhe <i>analizon</i> pjesët përbërëse të fjalëve; • <i>dallon dhe përdor me lehtësi</i> sinonimet, antonimet, homonimet, fjalët e urta dhe shprehjet frazeologjike.
---	--	--

4.2 Lënda: Gjuhë e huaj

Lënda e gjuhës së huaj ndihmon nxënësin të forcojë kompetencën e komunikimit dhe të shprehurit e cila përbëhet nga kompetencat lëndore të mëposhtme.

Tabela 4

PËRSHKRIMI I KOMPETENCAVE TË LËNDËS	
<p>1. Kompetenca gjuhësore</p>	<p>Nxënësi:</p> <p>Zotëron fjalor bazë me fjalë të shkëputura dhe shprehje që lidhen me situatë shumë konkrete; tregon kontroll të kufizuar mbi struktura shumë të thjeshta gramatikore dhe modele fjalish të mësuara paraprakisht; shqipton mirë një repertor të kufizuar fjalësh dhe shprehjesh dhe disa herë nuk mund të kuptohen nga një folës vendas i gjuhës; kopjon fjalë dhe shprehje të shkurtra të njohura për të si p.sh. emrat e sendeve, udhëzime, emrat e dyqaneve etj. Gërmëzon adresën e tij, kombësinë dhe detaje të tjera personale.</p>

2. Kompetenca socio-gjuhësore	Vendos kontakte shoqërore shumë të thjeshta duke përdorur përhëndetjet dhe shprehjet e përditshme të mirësjelljes si p.sh. të lutem, faleminderit, më vjen keq, mirupafshim etj.
3. Kompetenca pragmatike	Lidh fjalët në grupe fjalësh me lidhëset bashkërenditëse “dhe”, “pastaj”

Nxënësi kryen veprimtari të ndryshme dhe zhvillon aftësitë e mëposhtme për të përmbushur nivelet e arritjeve.

Tabela 5

KLASA IV-V		
Të dëgjuarit		
Përshkrimi		
Nxënësi kupton fjalë të njohura dhe shprehje të përditshme në lidhje me veten, familjen dhe mjedisin e afërt konkret, nëse njerëzit flasin ngadalë dhe qartë.		
Niveli 2	Niveli 3	Niveli 4
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • kupton fjalë të thjeshta të shkëputura kur ato shqiptohen ngadalë; • kupton përhëndetje të thjeshta të jetës së përditshme kur shoqërohen me figura ose pamje të ndryshme; • kupton pyetje të thjeshta rreth emrit, moshës, anëtarëve të familjes kur ato 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • kupton fjali të thjeshta, të cilat shqiptohen ngadalë; • kupton përhëndetje dhe udhëzime të thjeshta të cilat lidhen me gjuhën që përdoret në klasë; • kupton pyetje të thjeshta të cilat lidhen me jetën e përditshme (ditët e javës, frutat e preferuara, motrat, vëllezërit etj). 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • kupton dialogje të shkurtra të cilat shqiptohen qartë dhe ngadalë; • kupton pyetje dhe udhëzime të drejtuara me shumë kujdes dhe ngadalë si edhe ndjek drejtime të thjeshta dhe të shkurtra;

shqiptohen ngadalë, pastër dhe me pauza.		<ul style="list-style-type: none"> kupton dhe reagon kur e pyesin për gjërat që i pëlqejnë, (p.sh. stinët, lënda e preferuar etj.)
--	--	---

Të folurit

Përshkrimi

Nxënësi komunikon në mënyrë të thjeshtë, me kusht që bashkëfolësi të jetë i gatshëm të përsërisë apo të riformulojë frazat e tij më ngadalë dhe të jetë bashkëpunues.

Niveli 2	Niveli 3	Niveli 4
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> Përgjigjet me fjalë të shkëputura kur e pyesin për moshën, klasën etj. Përdor fjalë të shkëputura ose fjali të paplota kur flet për veten, shokët, prindërit etj. Tenton të marrë pjesë në një dialog të strukturuar duke thënë fjalë të shkëputura. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> Pyet dhe përgjigjet me fjali shumë të thjeshta dhe ndjek modelin e dhënë. Prezanton veten, familjen shokët duke përdorur fjali të shkurtra dhe shumë të thjeshta dhe ndjek pa ndryshim modelin e dhënë si edhe kërkon ndihmë kur ka paqartësi. Merr pjesë në një dialog të strukturuar dhe përdor fjali të thjeshta. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> Pyet dhe përgjigjet me fjali të thjeshta dhe përpiqet të jetë krijues nga modeli i dhënë. Prezanton veten, familjen, shokët, etj duke përdorur fjali të thjeshta dhe ndjek pa vështirësi modelet e dhëna. Merr pjesë në një bisedë të thjeshtë duke eksperimentuar me modelin e dhënë.

“Të lexuarit”

Përshkrimi

Nxënësi kupton emra të njohur, fjalë si edhe fraza të thjeshta, në lajmërimet, afishe e njoftime të ndryshme; përdor strategji të thjeshta për të kuptuar tekstin si: lidh figurën me fjalën, grupon fjalë sipas grupeve kuptimore.

Niveli 2	Niveli 3	Niveli 4
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none">dallon të dhënat personale në një pyetësor të thjeshtë dhe jep informacion me fjalë të shkëputura;kupton mesazhe shumë të shkurtra kur ato janë të shoqëruara me figura;identifikon personazhet në një tregim shumë të shkurtër të shoqëruar me figura.	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none">kupton informacionin e dhënë në një pyetësor kur ai ka modelin e mësuar më parë dhe jep informacionin e kërkuar me fjali shumë të thjeshta;kupton mesazhe, kartolina shumë të shkurtra dhe nxjerr informacionin e kërkuar me ndihmën e mësuesit;identifikon personazhet dhe idenë kryesore në një tregim të shkurtër të shoqëruar me figura.	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none">kupton informacionin e dhënë në një pyetësor të thjeshtë dhe fillon të eksperimentojë me informacionin që i kërkohet;kupton mesazhe, kartolina të shkurtra dhe nxjerr pa vështirësi informacionin e kërkuar;identifikon personazhet, idenë kryesore dhe detajet në një tregim të shkurtër të shoqëruar me figura.

“Të shkruarit”

Përshkrimi

Nxënësi shkruan fjalë dhe fjali të thjeshta, një kartolinë të shkurtër përshëndetjeje etj. Shkruan mbi tematika të njohura.

Niveli 2	Niveli 3	Niveli 4
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • kopjon dhe shkruan sipas modelit të dhënë fjalë dhe fjali shumë të shkurtra; • plotëson një formular shumë të thjeshtë ku i kërkohet të plotësojë vendet bosh; • shkruan një kartolinë urimi ku i kërkohet të plotësojë vendet bosh në fjali. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • shkruan fjali të shkurtra për të përshkruar veten , familjen, shokët duke ndjekur modelin e dhënë; • plotëson një formular të thjeshtë duke ndjekur modelin e dhënë; • shkruan një kartolinë urimi duke ndjekur modelin e dhënë. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • shkruan një paragraf shumë të shkurtër dhe përdor lidhëza dhe fjalët lidhëse si p.sh. “dhe”, “pastaj”; • plotëson pa vështirësi një formular të thjeshtë; • shkruan një kartolinë urimi, mesazh të thjeshtë dhe eksperimenton me fjalorin e mësuar.

“Përdorimi i drejtë i gjuhës”

Përshkrimi:

Nxënësi tregon kontroll të kufizuar mbi struktura shumë të thjeshta gramatikore dhe modele fjalish të mësuara paraprakisht; shqipton mirë një repertor të kufizuar fjalësh dhe shprehjesh

Niveli 2	Niveli 3	Niveli 4
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • shkruan me gabime drejtshkrimore dhe gërmëzon; • has vështirësi në dallimin e strukturave të ndryshme gramatikore. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • shkruan me pak gabime drejtshkrimore dhe gërmëzon; • has pak vështirësi në dallimin e strukturave të ndryshme gramatikore 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • shkruan pa gabime drejtshkrimore dhe gërmëzon • Nuk has vështirësi në dallimin e strukturave të ndryshme gramatikore.

5 NIVELET E ARRITJES SË KOMPETENCAVE NË FUSHËN “ MATEMATIKË”

Tabela 6

KLASA I-III			
Kompetenca 1: “Zgjidhja e situatës problemore”			
<i>Përshkrimi i kompetencës</i>			
<p>Nxënësi përshkruan dhe zgjidh situata problemore, të nivelit praktik të marra nga përvojat e përbashkëta të jetës së përditshme dhe të nivelit abstrakt, duke zhvilluar kapacitetin e tij intelektual dhe intuitën krijuese. Ai përcakton të dhënat e situatës problemore, e modelon atë, zbaton hapa të ndryshëm për zgjidhjen e saj, e vlerëson zgjidhjen dhe e paraqet atë.</p>			
Niveli 2	Niveli 3	Niveli 4	Niveli 5
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • kryen <i>me skema ndihmëse</i>, veprimet themelore matematikore me numra; • zbaton <i>me mbikëqyrje</i>, kërkesa të problemeve të thjeshta; • përdor mjete <i>të thjeshta</i> dhe arrin <i>me skema ndihmëse</i>, <i>disa rezultate</i> gjatë matjeve të objekteve në klasë dhe në jetën e përditshme. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • kryen, <i>pjesërisht</i>, veprimet themelore matematikore me numra; • zbaton <i>disa kërkesa të problemeve të thjeshta</i>; • përdor <i>mjete të thjeshta</i> gjatë matjeve të objekteve në klasë dhe në jetën e përditshme; • bën <i>pak</i> vrojtime që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • kryen, <i>i orientuar</i>, veprimet themelore matematikore me numra; • zbaton, <i>lehtësisht</i>, kërkesat e <i>problemeve të thjeshta</i>; • përdor <i>mjete themelore</i> gjatë matjeve të objekteve në klasë dhe në jetën e përditshme; • bën, <i>i orientuar</i>, vrojtime që 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • kryen <i>në mënyrë të pavarur</i> veprimet themelore matematikore me numra; • identifikon, <i>lehtësisht</i>, kërkesat e problemeve të thjeshta dhe zbaton <i>në mënyrë të pavarur</i>, teknika të zgjidhjes së problemave; • përdor, <i>lehtësisht</i> mjete dhe metoda themelore gjatë

	zotërimin e shprehive matematike.	ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike.	matjeve të objekteve në klasë dhe në jetën e përditshme; <ul style="list-style-type: none"> • bën vrojtime dhe hetime, që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike.
--	-----------------------------------	---	--

Kompetenca 2: “Arsyetimi dhe vërtetimi matematik”

Përshkrimi i kompetencës

Nxënësi përdor arsyetimin, argumentimin dhe vërtetimin si aspekte themelore të matematikës. Arsyetimi ka të bëjë me organizimin logjik të fakteve, ideve ose koncepteve në mënyrë që të arrijë në një rezultat më të besueshëm se intuita

Niveli 2	Niveli 3	Niveli 4	Niveli 5
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>kupton konceptin</i> e numërimit përmes numrave, ngjyrave, figurave, madhësive, vizatimeve dhe objekteve; • <i>ka njohuri</i> për shprehitë e arsyetimit për të kryer veprime. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • demonstroi, <i>pjesërisht</i>, të kuptuarit e konceptit të numërimit përmes numrave, ngjyrave, figurave, madhësive, vizatimeve dhe objekteve; • zbaton, <i>pjesërisht</i>, shprehitë të arsyetimit për të kryer veprime; • <i>njeh rregulla</i> por ka vështirësi 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • demonstroi, <i>i orientuar</i>, të kuptuarit e konceptit të numërimit përmes numrave, ngjyrave, figurave, madhësive, vizatimeve dhe objekteve; • zbaton, <i>me mbikëqyrje</i>, shprehitë të arsyetimit për të 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • demonstroi, <i>lehtësisht</i>, të kuptuarit e konceptit të numërimit përmes numrave, ngjyrave, figurave, madhësive, vizatimeve dhe objekteve; • zbaton, <i>në mënyrë të pavarur</i>, shprehitë të

	në gjykim gjatë diskutimeve me të tjerët.	kryer veprime dhe për të bërë hamendësime; <ul style="list-style-type: none"> • kupton, <i>rregulla</i> për të gjykuar gjatë diskutimeve me të tjerët. 	arsyetimit për të kryer veprime dhe për të bërë hamendësime; <ul style="list-style-type: none"> • dallon, <i>lehtësisht ligjësi (rregulla)</i>, për të gjykuar gjatë diskutimeve me të tjerët.
--	---	--	--

Kompetenca 3: “Të menduarit dhe komunikimi matematik”

Përshkrimi i kompetencës

Nxënësi përdor komunikimin nëpërmjet të lexuarit, të shkruarit, diskutimit, të dëgjuarit, të pyeturit për të organizuar dhe qartësuar të menduarin matematik. Nxënësi gjatë të menduarit dhe komunikimit në gjuhën matematikore mëson konceptet, proceset dhe përforcon të kuptuarit e tyre. Ai kupton se kjo gjuhë përdoret jo vetëm në lëndë të tjera, por edhe në jetën e përditshme.

Niveli 2	Niveli 3	Niveli 4	Niveli 5
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>ka njohuri për gjuhën natyrore dhe simbolet e thjeshta për veprimet matematikore;</i> • <i>ndërton, me skema ndihmëse, struktura të thjeshta për matematikën duke grumbulluar informacione nga shkolla dhe</i> 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>kupton gjuhën natyrore dhe simbolet e thjeshta për veprimet matematikore;</i> • <i>ndërton, me skema ndihmëse, struktura themelore të përshtatshme për matematikën duke grumbulluar informacione</i> 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>përdor, i orientuar, gjuhën natyrore dhe simbolet e thjeshta matematikore për përshkrimin e fakteve të thjeshta dhe veprimeve matematikore;</i> • <i>ndërton, me mbikëqyrje,</i> 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>përdor, lehtësisht, gjuhën natyrore dhe simbolet e thjeshta matematikore për marrjen dhe interpretimin e informacioneve;</i> • <i>ndërton struktura themelore të përshtatshme për</i>

<p>mjedisi jashtëskollor;</p> <ul style="list-style-type: none"> • kupton <i>me skema ndihmëse</i>, të menduarin matematik duke përdorur fjalorin <i>fillestar</i> të matematikës 	<p>nga shkolla dhe mjedisi jashtëskollor;</p> <ul style="list-style-type: none"> • komunikon, <i>me mbikëqyrje</i>, të menduarin matematik duke përdorur fjalorin <i>fillestar</i> të matematikës 	<p>struktura <i>themelore</i> të përshtatshme për matematikën duke grumbulluar informacione nga shkolla dhe mjedisi jashtëskollor;</p> <ul style="list-style-type: none"> • komunikon, <i>të menduarin</i> matematik duke përdorur fjalorin e matematikës. 	<p>matematikën duke grumbulluar informacione nga shkolla dhe mjedisi jashtëskollor;</p> <ul style="list-style-type: none"> • komunikon, <i>në mënyrë të pavarur</i>, të menduarin matematik nëpërmjet të folurit, të shkruarit, të dëgjuarit; • krijon, <i>paraqitje</i> të koncepteve të thjeshta matematike me mjete konkrete, lëvizje fizike, vizatime, numra, simbole dhe i zbaton në zgjidhje problemash.
--	--	---	--

Kompetenca 4: “Lidhja konceptuale”

Përshkrimi i kompetencës

Nxënësi kupton ndërtimin e koncepteve matematike për të formuar një të tërë dhe përdor varësitë ndërmjet këtyre koncepteve. Arsyetimi matematik zhvillon lidhjen ndërmjet koncepteve duke i ndërtuar dhe zbatuar ato në proceset matematikore përkatëse.

Niveli 2	Niveli 3	Niveli 4	Niveli 5
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>kupton me skema ndihmëse</i> lidhje të thjeshta mes numërimit dhe koncepteve themelore të gjeometrisë dhe të matjeve; • <i>bën lidhje, me skema ndihmëse, ndërmjet njohurive dhe shprehive matematikore me situata të thjeshta.</i> 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>kupton</i> lidhje të thjeshta mes numërimit dhe koncepteve themelore të gjeometrisë dhe të matjeve; • <i>bën lidhje të pjesshme, ndërmjet njohurive dhe shprehive matematikore me situata të thjeshta.</i> 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>bën, me mbikëqyrje, lidhje të thjeshta mes numërimit dhe koncepteve themelore të gjeometrisë dhe të matjeve;</i> • <i>bën, me skema ndihmëse, lidhje ndërmjet njohurive dhe shprehive matematikore me situata të familjarizuara</i> 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>bën, lehtësisht, në mënyrë të vazhduar, lidhje të thjeshta mes numërimit dhe koncepteve themelore të gjeometrisë dhe të matjeve;</i> • <i>bën, në mënyrë të pavarur, lidhje ndërmjet njohurive dhe shprehive matematikore me situata nga jeta e përditshme.</i>

Kompetenca 5: “Modelimi matematik”

Përshkrimi i kompetencës

Nxënësi përshkruan dhe krijon modele duke përdorur veprimet themelore matematikore në situata të jetës së përditshme. Modelimi është procesi i paraqitjes së situatës nga jeta reale me gjuhën matematikore. Nëpërmjet përdorimit të teknikave përkatëse, gjendet zgjidhja matematikore e cila më pas interpretohet në jetën reale

Niveli 2	Niveli 3	Niveli 4	Niveli 5
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>ka njohuri dhe kupton</i> vetitë e figurave dhe objekteve të 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>zbaton</i> vetitë e figurave dhe objekteve të ndryshme; 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>identifikon, i orientuar, vetitë e figurave dhe</i> 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>identifikon, lehtësisht, vetitë e figurave dhe</i>

<p>ndryshme;</p> <ul style="list-style-type: none"> dallon, <i>me skema ndihmëse</i>, figurat dhe objektet sipas këtyre vetive; lidh, <i>me ndihmë</i>, numrat dhe figurat me situata konkrete. 	<ul style="list-style-type: none"> klasifikon, <i>me skema ndihmëse</i>, figurat dhe objektet sipas këtyre vetive; paraqet, <i>pjesërisht, me skema ndihmëse</i>, numrat, figurat dhe konceptet e thjeshta matematikore. 	<p>objekteve të ndryshme;</p> <ul style="list-style-type: none"> klasifikon, <i>me mbikëqyrje</i>, figurat dhe objektet sipas këtyre vetive, krijon, <i>pjesërisht</i>, modele të thjeshta të figurave dhe objekteve nga klasa dhe nga jeta e përditshme duke përdorur numrat; paraqet, <i>me skema ndihmëse</i>, numrat, figurat dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete 	<p>objekteve të ndryshme;</p> <ul style="list-style-type: none"> klasifikon, <i>në mënyrë të pavarur</i>, figurat dhe objektet sipas këtyre vetive, krijon modele të thjeshta të figurave dhe objekteve nga klasa dhe nga jeta e përditshme duke përdorur numrat; paraqet, <i>lehtësisht</i>, numrat, figurat dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.
---	--	---	--

Tabela 7

KLASA IV -V		
Kompetenca 1: “Zgjidhja e situatës problemore”		
<i>Përshkrimi i kompetencës</i>		
<p>Nxënësi përshkruan dhe zgjidh situata problemore, të nivelit praktik të marra nga përvojat e përbashkëta të jetës së përditshme dhe të nivelit abstrakt, duke zhvilluar kapacitetin e tij intelektual dhe intuitën krijuese. Ai përcakton të dhënat e situatës problemore, e modelon atë, zbaton hapa të ndryshëm për zgjidhjen e saj, e vlerëson zgjidhjen dhe e paraqet atë.</p>		
Niveli 2	Niveli 3	Niveli 4
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • kryen, <i>me mbikëqyrje</i>, veprime matematikore me numrat deri në gjashtëshifrorë dhe ka njohuri për numrat e plotë negativë dhe thyesat; • ka njohuri për hapat e zgjidhjes së problemave; • përdor mjete të <i>thjeshta</i> për matjen e figurave 2D (D = dimensionale) dhe objekteve 3D; • përdor, <i>me skema ndihmëse</i>, formula të <i>thjeshta</i> që lidhen me vetitë e figurave 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • kryen veprime matematikore me numrat deri në gjashtëshifrorë dhe kupton, <i>me mbikëqyrje</i>, numrat e plotë negativë dhe thyesat; • përshkruan kërkesat e <i>problemeve të thjeshta</i>, përdor <i>me mbikëqyrje</i> hapat e zgjidhjes së problemave; • kryen <i>me skema ndihmëse</i> vrojtime, që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike; 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • kryen <i>në mënyrë të pavarur</i> veprimet themelore matematikore me numrat deri në gjashtëshifrorë dhe kupton numrat e plotë negativë dhe thyesat; • përshkruan kërkesat e <i>problemeve, zhvillon, përzgjedh</i> dhe zbaton strategjitë e zgjidhjes së problemave; • bën, <i>lehtësisht</i>, vrojtime, hetime, që ndihmojnë në të kuptuarit, vlerësimin e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike;

<p>gjeometrike për zgjidhjen e <i>situatave të thjeshta</i> problemore.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • përdor mjete praktike për matjen e figurave 2D (D = dimensionale) dhe objekteve 3D; • zbaton formula për zgjidhjen e problemave që lidhen me vetitë e figurave gjeometrike në <i>situata të thjeshta të njohura</i>; • bën me mbikëqyrje interpretime të pjesshme për të dhëna të paraqitura me diagrame me shtylla ose tabela. 	<ul style="list-style-type: none"> • përdor mjete dhe metoda të thjeshta për matjen e figurave 2D (D = dimensionale) dhe objekteve 3D duke kaluar <i>lehtësisht</i> nga një njësi matjeje në tjetrën; • zbaton formulat për zgjidhjen e problemave që lidhen me vetitë e figurave gjeometrike në <i>situata të reja</i> me të cilat ai nuk është i familjarizuar; • krijon paraqitje me tabela ose me diagrame, vlerëson dhe interpreton të dhëna të mbledhura.
---	---	--

Kompetenca 2: “Arsyetimi dhe vërtetimi matematik”

Përshkrimi i kompetencës

Nxënësi përdor arsyetimin, argumentimin dhe vërtetimin si aspekte themelore të matematikës. Arsyetimi ka të bëjë me organizimin logjik të fakteve, ideve ose koncepteve në mënyrë që të arrijë në një rezultat më të besueshëm se intuita.

Niveli 2	Niveli 3	Niveli 4
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • ka njohuri të pjesshme për rregulla, arsyeton, me skema ndihmëse, koncepte të thjeshta matematikore; 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • zbaton rregulla, arsyeton me mbikëqyrje koncepte dhe modele të thjeshta matematikore; 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • nxjerr në mënyrë të pavarur rregulla, arsyeton koncepte dhe modele të thjeshta matematikore, duke hapur rrugën për koncepte të reja;

<ul style="list-style-type: none"> dallon, <i>me mbikqyrje</i>, marrëdhëniet ndërmjet numrave dhe figurave gjeometrike; përdor, <i>me mbikëqyrje</i>, disa koncepte për të përshkruar situata probabilitare të thjeshta nga jeta e tyre e përditshme. 	<ul style="list-style-type: none"> zbaton, <i>i orientuar</i>, shprehi të arsyetimit si klasifikimi, dallimi i marrëdhënieve ndërmjet numrave dhe figurave gjeometrike; hamendëson, argumenton, <i>me skema ndihmëse</i>, rezultatin; parashikon, <i>me mbikëqyrje</i>, përfundimin e një matjeje; <i>kupton pjesërisht</i> terminologji të përshtatshme për të përshkruar situata probabilitare të thjeshta nga jeta e tyre e përditshme. 	<ul style="list-style-type: none"> <i>zhvillon dhe zbaton</i> shprehi të arsyetimit si klasifikimi, dallimi i marrëdhënieve ndërmjet numrave, figurave gjeometrike; <i>zhvillon përdorimin empirik</i> të kundërshembullit; hamendëson dhe <i>grykon hamendësime</i>, argumenton dhe mbron lehtësisht argumentin dhe rezultatin; parashikon, <i>në mënyrë të pavarur dhe identifikon</i> përfundimin e një matjeje; <i>zbulon</i> situata probabilitare të thjeshta nga jeta e tyre e përditshme dhe përdor terminologjinë e përshtatshme për t'i përshkruar ato.
---	--	--

Kompetenca 3: “Të menduarit dhe komunikimi matematik”

Përshkrimi i kompetencës

Nxënësi përdor komunikimin nëpërmjet të lexuarit, të shkruarit, diskutimit, të dëgjuarit, të pyeturit për të organizuar dhe qartësuar të menduarin matematik. Nxënësi gjatë të menduarit dhe komunikimit në gjuhën matematikore mëson konceptet, proceset dhe përforcon të kuptuarit e tyre. Ai kupton se kjo gjuhë përdoret jo vetëm në lëndë të tjera, por edhe në jetën e përditshme.

Niveli 2

Niveli 3

Niveli 4

Nxënësi:

- përforcon, *me mbikëqyrje*, strukturat mendore të ndërtuara më parë, të përshtatshme për matematikën;
- lidh, *me skema ndihmëse*, gjuhën natyrore me simbolet matematikore për të shprehur konceptet në matematikë;
- *ka njohuri* për algoritmin e veprimeve me numra për të bërë njehsime me mend;
- *ërpiket të komunikojë* të menduarin e tij matematik (nëpërmjet të lexuarit, të shkruarit, të dëgjuarit).

Nxënësi:

- përdor, *i orientuar*, strukturat mendore të ndërtuara më parë, të përshtatshme për matematikën;
- lidh, *me mbikëqyrje*, gjuhën natyrore me simbolet matematikore për të organizuar faktet, konceptet në matematikë;
- *kupton dhe ka njohuri* për algoritmin e veprimeve me numra për të bërë njehsime me mend;
- *komunikon* të menduarin e tij matematik (nëpërmjet të lexuarit, të shkruarit, diskutimit, të dëgjuarit, të pyeturit).

Nxënësi:

- demonstroi *të menduar të pavarur* dhe shprehi punë;
- përforcon strukturat mendore të ndërtuara më parë, të përshtatshme për matematikën duke parashtruar, pranuar dhe përgjigjur pyetjeve;
- përdor, *lehtësisht*, gjuhën natyrore dhe simbolet matematikore për të organizuar faktet, konceptet, idetë dhe veprimet themelore në matematikë;
- përdor, *në mënyrë të pavarur*, algoritmin e veprimeve me numra për të bërë njehsime me mend;
- krijon, *i pavarur*, paraqitje të koncepteve matematike me mjete konkrete, vizatime numra, simbole, tabela, diagrame duke komunikuar, *lehtësisht*, të menduarin e tij matematik (nëpërmjet të lexuarit, të shkruarit, diskutimit, të dëgjuarit, të pyeturit).

Kompetenca 4: “Lidhja konceptuale”

Përshkrimi i kompetencës

Nxënësi kupton ndërtimin e koncepteve matematike për të formuar një të tërë dhe përdor varësitë ndërmjet këtyre koncepteve. Arsytimi matematik zhvillon lidhjen ndërmjet koncepteve duke i ndërtuar dhe zbatuar ato në proceset matematikore përkatëse.

Niveli 2	Niveli 3	Niveli 4
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none">• <i>kupton, me mbikëqyrje, lidhjen ndërmjet njohurive të mëparshme dhe njohurive të reja për ndërtimin e koncepteve në lidhje me numrat deri në gjashtëshifrorë, të figurave 2D dhe objekteve 3D;</i>• <i>bën lidhje të pjesshme, me skema ndihmëse, të njohurive dhe shprehive matematike me situata praktike.</i>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none">• <i>bën, me mbikëqyrje, lidhje ndërmjet njohurive të mëparshme dhe njohurive të reja për ndërtimin e koncepteve në lidhje me numrat deri në gjashtëshifrorë, të figurave 2D dhe objekteve 3D;</i>• <i>bën lidhje, i orientuar, të njohurive dhe shprehive matematike me situata ose dukuri të familjarizuara.</i>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none">• <i>bën, lehtësisht e në mënyrë të vazhduar, lidhje ndërmjet njohurive të mëparshme dhe njohurive të reja për ndërtimin e koncepteve në lidhje me numrat deri në gjashtëshifrorë, të figurave 2D dhe objekteve 3D;</i>• <i>bën lidhje të njohurive dhe shprehive matematike me situata ose dukuri të marra nga jeta e përditshme me të cilat nuk është familjarizuar, lëndët e tjera, sportet etj.;</i>• <i>bën, i pavarur, krahasime ndërmjet koncepteve e procedurave matematikore.</i>

Kompetenca 5: “Modelimi matematik”

Përshkrimi i kompetencës

Nxënësi përshkruan dhe krijon modele duke përdorur veprimet themelore matematikore në situata të jetës së përditshme. Modelimi është procesi i paraqitjes së situatës nga jeta reale me gjuhën matematikore. Nëpërmjet përdorimit të teknikave përkatëse, gjendet zgjidhja matematikore e cila më pas interpretohet në jetën reale

Niveli 2	Niveli 3	Niveli 4
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>kupton, me mbikëqyrje</i>, modele të veprimeve themelore matematikore që lidhen me numrat deri në gjashtëshifrorë, figurat 2D dhe objektet 3D. • <i>përdor</i> të dhëna, <i>me skema ndihmëse</i>, për modelime për marrëdhënie funksionale, bazuar në kuptimin për vargun, funksionin dhe simbolet algjebrike. • <i>zgjdh pjesërisht, me mbikëqyrje</i>, ekuacione dhe inekuacione të thjeshta (në përshtatje me njohuritë e shprehite e mësuara). 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • përshkruan, <i>me skema ndihmëse</i>, modele duke përdor veprimet themelore matematikore në situata të njohura, që lidhen me numrat deri në gjashtëshifrorë, figurat 2D dhe objektet 3D; • <i>zbaton, i orientuar</i>, modelime për marrëdhënie funksionale, bazuar në kuptimin për vargun, funksionin dhe simbolet algjebrike; • <i>zgjdh, me mbikëqyrje</i>, ekuacione dhe inekuacione të thjeshta (në përshtatje me njohuritë e shprehite e mësuara); • <i>zbaton, me skema ndihmëse</i>, rregullat themelore për njehsimet me numra 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>krijon, në mënyrë të pavarur</i>, modele dhe i përshkruan duke përdor veprimet themelore matematikore në situata të jetës së përditshme (p.sh. të ekonomisë familjare, statistika elementare për jetën, etj), që lidhen me numrat deri në gjashtëshifrorë, figurat 2D dhe objektet 3D; • <i>krijon dhe vlerëson</i> ligjësi dhe modelime për marrëdhënie funksionale, bazuar në kuptimin për vargun, funksionin dhe simbolet algjebrike; • <i>modelon dhe zgjidh, në mënyrë të pavarur</i>, ekuacione dhe inekuacione (në përshtatje me njohuritë e shprehite e mësuara) dhe parashikon me afërsi rezultatin; • <i>identifikon rregullat themelore</i> për njehsimet

duke përdorur ndryshoret për zgjidhjen e problemeve nga matematika dhe jeta e përditshme.

me numra duke përdorur ndryshoret për zgjidhjen e problemeve nga matematika dhe jeta e përditshme.

6 NIVELET E ARRITJES SË KOMPETENCAVE NË FUSHËN “SHKENCAT E NATYRËS”

Për veçoritë e zhvillimit moshor, nivelet e arritjes së rezultateve të të nxënit sipas kompetencave jepen për klasat I-III dhe 4-5 për tri kompetencat së bashku, sipas një kompetence të integruar “Kërkimi shkencor”.

6.1 Lënda “Dituri natyre”

Tabela 8

KLASA I-III			
Kompetenca e integruar: “Kërkimi shkencor”			
Përshkrimi i kompetencës			
<p>Nxënësi identifikon një problem ose përcakton një grup problemesh dhe përdor strategji të ndryshme eksplorimi. Ai vlerëson qasjen e vet dhe të të tjerëve. Nxënësi familjarizohet me rolet dhe funksionet e mjeteve, teknikave, instrumenteve, procedurave shkencore dhe teknologjike, i përdor ato në përputhje me situatat dhe mënyrat e përdorimit të tyre në to dhe vlerëson ndikimin e mjeteve, instrumenteve dhe procedurave. Ai familjarizohet me gjuhën e jetës së përditshme që lidhet me shkencën dhe teknologjinë, përdor efektivisht gjuhën e simboleve dhe të jetës së përditshme për shkencën dhe teknologjinë, për të formuluar pyetje dhe për të argumentuar përgjigjet.</p>			
Niveli 2	Niveli 3	Niveli 4	Niveli 5
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>zbulon pak elemente të një problemi;</i> • <i>me ndihmë, bazuar në njohuritë që ka, eksploron idetë për</i> 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>zbulon pak elemente shkencore dhe teknologjike të një problemi dhe e shpjegon natyrën e problemit me fjalët e veta;</i> 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>njih dhe pranon pak elemente shkencore dhe teknologjike të një problemi;</i> • <i>vendos lidhjet mes elementeve të problemit;</i> 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>njih dhe pranon disa elemente shkencore dhe teknologjike të një problemi;</i>

<p>shpjegimet ose zgjidhjet që lidhen me problemin;</p> <ul style="list-style-type: none"> • bën vrojtime, manipulon objektet, bazuar në burimet e mundshme të informacionit (shokët e klasës, ekspertë, burime të shkruara) për të gjetur ide dhe për të dhënë shpjegime ose zgjidhje; • <i>me ndihmë</i>, planifikon një shpjegim, një zgjidhje ose një mënyrë të bërjes së gjërave dhe e zbaton atë; • përdor instrumente dhe mjete të rekomanduara gjatë shpjegimeve ose zbatimeve të zgjidhjeve; • <i>me ndihmë</i>, nxënësi paraqet shpjegimet ose zgjidhjet e veta, duke përdorur pak terma ose shprehje shkencore ose 	<ul style="list-style-type: none"> • bazuar në njohuritë që ka dhe <i>me ndihmë</i>, nëse është e nevojshme, <i>eksploron idetë</i> për shpjegimet ose zgjidhjet që lidhen me problemin; • bën vrojtime, manipulon objektet dhe <i>bazuar në burimet</i> e informacionit (shokët e klasës, ekspertët, burimet e shkruara) në përpjekjet për të identifikuar shpjegimet ose zgjidhjet e mundshme; • <i>thërret një person burimor</i> nëse i nevojitet <i>ndihmë</i> për të zgjedhur shpjegimin, zgjidhjen ose mënyrën e bërjes së gjërave si dhe për shpjegimin ose zbatimin e zgjidhjes që ka zgjedhur; • <i>me ndihmë</i>, nxënësi përdor në mënyrë të përshtatshme 	<ul style="list-style-type: none"> • <i>ndonjëherë riformulon</i> problemin <i>me fjalët e veta</i>; • bazuar në njohuritë që ka, <i>eksploron idetë</i> për shpjegimet ose zgjidhjet që lidhen me problemin; • <i>bën vrojtime, manipulon objektet</i> dhe merr informacionin nga <i>shumëllojshmëri burimesh</i> për të zgjedhur <i>një ose më shumë</i> shpjegime ose zgjidhje; • <i>zgjedh mënyrën e bërjes së gjërave</i> që i takon shpjegimit ose zgjidhjes që ka zgjedhur, <i>me ndihmë</i> nëse është e nevojshme; • <i>me ndihmë</i>, ai <i>zgjedh instrumentet</i> dhe veglat e kërkuara dhe <i>i përdor</i> ato në mënyrë të përshtatshme; 	<ul style="list-style-type: none"> • <i>vendos lidhjet</i> mes elementeve të problemit; • <i>shpesh riformulon</i> problemin <i>me fjalët e veta</i>; • bazuar në njohuritë që ka, <i>eksploron idetë</i> për shpjegimet ose zgjidhjet që lidhen me problemin; • bën vrojtime, manipulon objektet dhe merr informacionin nga <i>shumëllojshmëri burimesh</i> për të zgjedhur <i>një ose më shumë</i> shpjegime ose zgjidhje; • <i>zgjedh rrallëherë me ndihmë</i> mënyrën e bërjes së gjërave; • <i>rrallëherë me ndihmë</i>, <i>zgjedh instrumentet</i> dhe veglat e kërkuara dhe i
---	---	---	--

<p>teknologjike specifike si dhe të paktën një tip prezantimi.</p>	<p>instrumentet dhe mjetet kur shpjegon ose zbaton zgjidhjet e tij.</p> <ul style="list-style-type: none"> • prezanton shpjegimet ose zgjidhjet e tij, duke përdorur pak terma ose shprehje specifike shkencore dhe pak tipa prezantimesh. 	<ul style="list-style-type: none"> • prezanton shpjegimet ose zgjidhjet e tij, duke përdorur pak terma të specializuar shkencorë dhe teknologjikë ose shprehje dhe shumëllojshmëri tipash të prezantimeve. 	<p>përdor ato në mënyrë të përshtatshme;</p> <ul style="list-style-type: none"> • prezanton shpjegimet ose zgjidhjet e tij, duke përdorur saktë disa terma specifikë shkencorë dhe teknologjikë ose shprehje dhe shumëllojshmëri prezantimesh.
--	---	---	---

Tabela 9

KLASA IV -V		
Kompetenca e integruar: “Kërkimi shkencor”		
<i>Përshkrimi i kompetencës</i>		
<p>Nxënësi identifikon një problem ose përcakton një grup problemesh dhe përdor strategji të ndryshme eksplorimi. Ai vlerëson qasjen e vet dhe të të tjerëve. Nxënësi familjarizohet me rolet dhe funksionet e mjeteve, teknikave, instrumenteve, procedurave shkencore dhe teknologjike, i përdor ato në përputhje me situatat dhe mënyrat e përdorimit të tyre në to dhe vlerëson ndikimin e mjeteve, instrumenteve dhe procedurave. Ai familjarizohet me gjuhën e jetës së përditshme që lidhet me shkencën dhe teknologjinë, përdor efektivisht gjuhën e simboleve dhe të jetës së përditshme për shkencën dhe teknologjinë, për të formuluar pyetje dhe për të argumentuar përgjigjet.</p>		
Niveli 2	Niveli 3	Niveli 4
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>njih dhe pranon</i> elementet shkencore ose teknologjike të një problemi; • <i>me ndihmë</i>, nxënësi vendos lidhjet midis njohurive që ka dhe shpjegimeve <i>tentative</i> për zgjidhjen e problemit; • bën vëzhgime, manipulon objektet, bazuar në shumëllojshmëri burimesh të informacionit (shokët e klasës, ekspertë, burime të shkruara) për zgjedhjen e <i>një ose</i> 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>shquan</i> elementet shkencore ose teknologjike të një problemi dhe shpjegon natyrën e problemit <i>me fjalët e veta</i>; • <i>me ndihmë</i>, në disa <i>situata më komplekse</i>, vendos lidhjet ndërmjet njohurive që ka dhe shpjegimeve <i>tentative</i> që lidhen me zgjidhjet; • bën vëzhgime, manipulon objekte dhe <i>një shumëllojshmëri burimesh</i> të informacionit <i>për të zgjedhur një ose më shumë</i> shpjegime 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>shquan</i> elementet teknike ose shkencore të një problemi; • <i>vendos lidhjet</i> midis elementeve dhe problemit dhe <i>përherë riformulon</i> problemin <i>me fjalët e veta</i>; • <i>vendos lidhjet</i> midis njohurive që ka dhe shpjegimeve <i>tentative</i> të zgjidhjeve të problemit; • bën vëzhgime, manipulon objektet dhe informacionin nga <i>shumëllojshmëri</i>

<p><i>më shumë</i> shpjegimeve ose zgjidhjeve të mundshme dhe <i>formulon zgjedhjet</i>;</p> <ul style="list-style-type: none"> • kërkon <i>ndihmë</i> për zgjedhjen e një metode të përshtatshme të mbledhjes së informacionit gjatë shpjegimit ose zbatimit të zgjidhjes; • kërkon <i>ndihmë</i> për zgjedhjen e instrumenteve dhe mjeteve të nevojshme dhe i përdor ato në mënyrë të përshtatshme; • <i>me ndihmë</i>, vlerëson <i>rezultatet</i> dhe, nëse është e nevojshme, <i>sugjeron ndryshimet</i> për mënyrën e bërjes së gjërave ose të zbatimit të shpjegimit ose zgjidhjes; • prezanton shpjegimet ose zgjidhjet, duke përdorur <i>pak</i> terma dhe shprehje shkencore dhe teknologjike specifike si dhe <i>tipa të ndryshëm</i> prezantimesh. 	<p>ose zgjidhje të mundshme dhe <i>disa herë i justifikon</i> ato;</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>me ndihmë</i>, në <i>disa situata më komplekse</i>, zgjedh një metodë të përshtatshme të mbledhjes së informacionit gjatë shpjegimit ose zbatimit të zgjidhjes që ka zgjedhur; • zgjedh mjetet dhe instrumentet e përshtatshme dhe <i>preokupohet për saktësinë</i> e përdorimit të tyre; • vlerëson rezultatet <i>me ndihmë</i>, sugjeron ndonjë ndryshim të përshtatshëm në mënyrën e vet të bërjes së gjërave ose në shpjegimin ose zbatimin e zgjidhjes; • formulon shpjegime ose zgjidhje të mundshme; • prezanton shpjegimet ose zgjidhjet e veta, duke përdorur <i>disa aspekte gjuhësore</i> të shkencës dhe teknologjisë; • është <i>i kujdesshëm</i> në ndjekjen e konvencioneve në përdorimin e grafikëve, shënimeve dhe simboleve. 	<p><i>burimesh</i> për të zgjedhur <i>një ose më shumë</i> shpjegime ose zgjidhje të mundshme dhe <i>përherë i justifikon</i> ato;</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>përdor gjithmonë</i> metodën e përshtatshme për mbledhjen e informacionit kur zbaton një mënyrë të bërjes së gjërave në përputhje me shpjegimin ose zgjidhjen e zgjedhur; • <i>preokupohet vazhdimisht për saktësinë</i> e zgjedhjes dhe të përdorimit të mjeteve dhe instrumenteve të përshtatshme; • <i>vlerëson saktë dhe përherë rezultatet</i> dhe <i>sugjeron ndryshimet</i> e nevojshme në mënyrën e vet të bërjes së gjërave si dhe të zbatimit të shpjegimit ose zgjidhjes; • <i>formulon shpjegime ose zgjidhje të tjera</i> të mundshme <i>sa herë që i</i>
---	---	---

		<p><i>kërkohet, në situatat ekzistuese dhe të reja;</i></p> <ul style="list-style-type: none">• prezanton shpjegimet ose zgjidhjet e veta në <i>mënyrë të strukturuar</i>, duke përdorur <i>saktë</i> gjuhën e shkencës dhe të teknologjisë;• ndjek <i>gjithmonë, saktë</i>, konvencionet e grafikëve, shenjat dalluese dhe simbolet.
--	--	--

7 NIVELET E ARRITJES SË KOMPETENCAVE NË FUSHËN “SHOQËRIA DHE MJEDISI”

7.1 Lënda: Histori

Tabela 10

KLASA IV -V
Kompetenca 1: “Kërkimi historik dhe analiza shkak-pasojë”
<i>Përshkrimi i kompetencës</i>
<p>Nxënësi përcakton dhe kryen kërkim për një ngjarje/çështje të caktuar historike nga historia personale, historia lokale, historia e vendit të tij apo historia e qytetërimeve botërore për periudha të ndryshme historike. Ai shtron pyetje për të shkuarën dhe shqyrton një sërë burimesh historike dhe informacioni, si bazë për t’iu përgjigjur këtyre pyetjeve dhe për të ndërtuar ngjarjen/çështjen historike. Harton dhe përmirëson pyetje për të strukturuar një shqyrtim për zhvillimin e hipotezave, për përzgjedhjen dhe dhënien e fakteve për të nxjerrë dhe për të justifikuar konkluzionet e tij/saj për ngjarjen/çështjen/figurën historike për të cilën zhvillohet kërkimi historik.</p> <p>Nxënësi, nëpërmjet kërkimit për të kaluarën dhe trashëgimisë së saj, zhvillon dhe ndërton konceptet historike që lidhen me kohën dhe kronologjinë, vazhdimësinë dhe ndryshimin në marrëdhëniet shoqërore, vijimësinë e ngjarjeve në të kaluarën dhe lidhjen e tyre shkak-pasojë, rolin e tyre në perspektivat e së ardhmes, fillimisht nëpërmjet kuptimit të historisë personale dhe familjare, historisë së shkollës, historisë zonës, rajonit, për t’u zgjeruar më pas në kuptimin e historisë së vendit dhe atë të qytetërimeve botërore. Ai vendos ngjarjet, njerëzit dhe ndryshimet në periudhën e saktë kohore duke bërë lidhjet ndërmjet ngjarjeve kryesore, situatave dhe ndryshimeve për një periudhe të caktuar historike dhe për periudha të ndryshme të shoqërisë. Vlerëson shumëllojshmërinë kulturore, etnike dhe fetare, përcakton marrëdhëniet shkak-pasojë, rëndësinë dhe perspektivat për ngjarjen/çështjen historike dhe kupton se kultura e vendit të tij dhe kulturat e tjera janë pjesë e një procesi historik. Nxënësi</p>

analizon ngjarjet historike në lidhjet e tyre shkak-pasojë dhe shpjegon pasojat në përfundimin e ngjarjeve, të situatave dhe të ndryshimeve historike.

Niveli 2	Niveli 3	Niveli 4
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • me ndihmën e mësueses <i>formulon pyetje bazuar vetëm në një aspekt të ngjarjes/çështjes historike, të historisë personale/ zonës/vendit ose më gjerë për të cilën zhvillohet kërkimi, duke iu referuar burimeve;</i> • <i>identifikon disa prej koncepteve historike si: koha dhe kronologjia, shumëllojshmëria kulturore, etnike dhe fetare, ndryshimi dhe vazhdimësia dhe rëndësia historike të ngjarjes/çështjes apo figurës historike për të cilën zhvillohet kërkimi;</i> • <i>dallon lidhjet shkak-pasojë për identifikimin e ngjarjes/çështjes apo figurës historike për të cilën zhvillohet kërkimi;</i> 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>me ndihmën e mësueses formulon një numër të caktuar pyetjesh për aspekte thelbësore të historisë personale, së zonës/vendit e më gjerë, duke përdorur ndonjë prej burimeve historike të përcaktuara;</i> • <i>përdor disa prej koncepteve historike si: koha dhe kronologjia, shumëllojshmëria kulturore, etnike dhe fetare, ndryshimi dhe vazhdimësia dhe rëndësia historike për identifikimin e ngjarjes/çështjes apo figurës historike për të cilën zhvillohet kërkimi;</i> • <i>identifikon marrëdhëniet shkak-pasojë për identifikimin e ngjarjes/çështjes apo figurës historike për të cilën zhvillohet kërkimi;</i> 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>kërkon dhe formulon pyetje për çështje/ngjarje/personale, familjare apo për çështje/ngjarje/figura të historisë së zonës/vendit e më gjerë duke përdorur burime të thjeshta historike;</i> • <i>përdor me korrektësi konceptet historike si: koha dhe kronologjia, shumëllojshmëria kulturore, etnike dhe fetare, ndryshimi dhe vazhdimësia dhe rëndësia historike për shpjegimin e ngjarjes/çështjes apo figurës historike;</i> • <i>përcakton lidhjet shkak-pasojë në ngjarjet historike, vlerëson rëndësinë e së kaluarës në jetën e tij dhe tregon mënyrën si ata ngjasojnë dhe diferencohen nga të tjerët në raport me kohën dhe hapësirën;</i> • <i>përdor saktë konceptet që lidhen me</i>

<ul style="list-style-type: none"> identifikon ndonjë prej koncepteve historike që lidhet me ngjarjen/çështjen historike në shqyrtim. 	<ul style="list-style-type: none"> identifikon disa prej koncepteve që lidhen me ngjarjen/çështjen historike në shqyrtim. 	ngjarjen/çështjen historike në shqyrtim.
--	--	--

Kompetenca 2: “Përdorimi i burimeve dhe interpretimi historik”

Përshkrimi i kompetencës

Nxënësi identifikon dhe shqyrton burimet historike dhe burimet e informacionit që përdor për kërkim. Vlerëson burimet për vlefshmërinë dhe besueshmërinë e tyre.

Nxënësi përdorë burime të sakta historike për të kuptuar lidhjet e brendshme e të jashtme midis ngjarjeve, periudhave dhe shoqërive të ndryshme, marrëdhëniet shkak-pasojë, si dhe lidhjet e qytetërimit të popullit shqiptar me qytetërimet botërore, duke shpjeguar se qytetërimet e sotme janë një vazhdimësi progresive e qytetërimeve të hershme, pra e sotmja e ka burimin tek e kaluara dhe është e lidhur me të. Vlerëson burimet e përdorura për të arritur përfundime të arsyetuara dhe logjike.

Analizon dhe vlerëson në mënyrë kritike interpretimet për ngjarje apo dukuri të ndryshme historike, shpjegon se si dhe pse ngjarjet historike janë interpretuar në mënyra të ndryshme dhe vlerëson rëndësinë e ngjarjeve, të njerëzve dhe të zhvillimeve në kontekstin e tyre historik dhe në ditët e sotme. Shqyrton një sërë interpretimesh të së kaluarës për të vlerësuar vlefshmërinë e tyre.

Niveli 2	Niveli 3	Niveli 4
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> i referohet ndonjë prej burimeve historike të përcaktuara (dokumente, burime të shkruara, historinë gojore, medie, piktura, muze, galeri, fotografi, muzikë, internetin, objekte të ndryshme, veshje, 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> përdor disa prej burime historike (dokumente, burime të shkruara, historinë gojore, medie, piktura, muze, galeri, fotografi, muzikë, internetin, objekte të ndryshme, veshje, tregime, shkrime, 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> përdor burime historike si: dokumente, burime të shkruara, historinë gojore, medie, piktura, muze, galeri, fotografi, muzikë, internetin, objekte të ndryshme, ndërtesa, veshje, tregime, shkrime,

tregime, shkrime, dëshmitar, fakte nga arte, ndërtesa historike) për t'iu përgjigjur dhe për të interpretuar ndonjë nga pyetjet e bëra për një ngjarje të caktuar nga historia personale, familjare apo historia e zonës/vendit e më gjerë.	dëshmitar, fakte nga arte, ndërtesa historike) për t'iu përgjigjur pyetjeve dhe për të shpjeguar dhe interpretuar një ngjarje të caktuar nga historia personale, familjare apo historia e zonës/vendit e më gjerë.	dëshmitar, fakte nga arte për të ndërtuar dhe interpretuar një ngjarje të caktuar nga historia personale, familjare apo historia e zonës/vendit e më gjerë.
---	--	---

Kompetenca 3: “Shpjegimi dhe komunikimi për të kaluarën”

Përshkrimi i kompetencës

Komunikon njohuritë historike në mënyra të ndryshme (me shkrim, me gojë, TIK) përmes përdorimit të burimeve të ndryshëm historik, duke përdorur fjalorin e përshtatshëm dhe të saktë historik. Ai mbledh informacion për një çështje të caktuar historike dhe e prezanton atë në mënyra alternativa para grupit.

Niveli 2	Niveli 3	Niveli 4
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • përdor me vështirësi fjalorin historik në lidhje me çështjet apo ngjarjen historike që trajtohet; • përdor me vështirësi hartat, burimet dhe konceptet historike për prezantimin e informacionit; • prezanton informacionin në mënyrë të çorganizuar. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • përdor disa nga mjetet e përshtatshme (p.sh. harta, grafikë, tabela, diagrame) për të organizuar informacionin historike dhe e prezanton atë para grupit; • përzgjedh disa të dhëna nga burime të ndryshme (si libra, revista, udhëzues, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • organizon informacion për një çështje të caktuar historike duke përdorur mjetet e përshtatshme (p.sh. harta, grafikë, tabela, diagrame) dhe e prezanton atë para grupit; • përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si libra, revista, udhëzues, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i

	<p>shfrytëzon për prezantimin e temës/detyrës së dhënë;</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>përdor në mënyrë të përshtatshme njohuritë dhe konceptet e mësuara historike.</i> 	<p>shfrytëzon për prezantimin e temës/detyrës së dhënë;</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>përdor saktë fjalorin historik.</i>
--	--	--

7.2 Lënda: Edukim për shoqërinë/ Qytetari

Tabela 11

Klasat I-V		
TEMATIKA: KULTURA		
<p>Përshkrimi i kompetencës:</p> <p>Në fund të klasës V, nxënësi duhet të jetë i aftë të eksplorojë dhe të shqyrtojë ngjashmëritë dhe ndryshimet në grupe të caktuara si familje, klasë, shkollë dhe shoqërinë në tërësi, duke shqyrtuar kulturat, nevojat e përbashkëta njerëzore dhe interesat e tyre; të japë shembuj se si përvojat e grupeve të caktuara mund të interpretohen ndryshe nga njerëz me prejardhje dhe këndvështrime të ndryshme kulturore; të shqyrtojë rrugët në të cilat gjuha shqipe, tregimet, folklori, muzika, krijimet i japin mundësi shprehjes së kulturës dhe ndikojnë në sjelljen e njerëzve, në jetën e tyre brenda një kulturë të veçantë; të krahasojë rrugët në të cilat njerëzit, në rrugë të ndryshme, mendojnë dhe ndajnë në mes tyre çështje të tilla si ajo e mjedisit fizik dhe kushteve sociale etj.; të japë shembuj dhe të shqyrtojë rëndësinë e unitetit kulturor dhe të diversitetit brenda dhe në mes grupeve të ndryshme si shkollë, komunitet, popullsi autoktone etj.</p>		
Niveli 2	Niveli 3	Niveli 4
Nxënësi:	Nxënësi:	Nxënësi:

<p>a. dallon ngjashmëri dhe ndryshime në mënyrën se si shokët dhe shoqet e klasës ose në komunitet i plotësojnë nevojat dhe interesat e tyre;</p> <p>b. dallon faktin që shokët dhe shoqet kanë pikëpamje të ndryshme për probleme dhe dukuri të ndryshme shoqërore;</p> <p>c. dallon raste të ndikimit të gjuhës, të traditave dhe të sjelljeve në zhvillimin e kulturës;</p> <p>d. dallon lidhje ndërmjet ndërmjet reagimeve të ndryshme të shokëve dhe shoqeve dhe prejardhjes së tyre të ndryshme;</p> <p>e. dallon raste të ndikimit dhe bashkëveprimit të njerëzve me prejardhje të ndryshme kulturore brenda dhe ndërmjet grupeve.</p>	<p>a. përshkruan ngjashmëritë dhe ndryshimet në mënyrën se si familjet dhe grupet e ndryshme i plotësojnë nevojat dhe interesat e tyre;</p> <p>b. dallon që këndvështrimet e ndryshme të shokëve dhe shoqeve lidhen me mënyrat e ndryshme të jetesës dhe prejardhjen e ndryshme kulturore etj.</p> <p>c. përshkruan shembuj të ndikimit të gjuhës dhe traditave familjare etj. që tejçojnë kulturën.</p> <p>d. përshkruan reagimet e ndryshme të shokëve dhe shoqeve ndaj mjedisit shoqëror e fizik për arsyes të ndryshmeve kulturore;</p> <p>e. krahason raste të ndikimit dhe bashkëveprimit të diversitetit kulturor brenda dhe ndërmjet grupeve.</p>	<p>a. krahason ngjashmëritë dhe ndryshimet në mënyrën se si familjet dhe grupet e ndryshme i plotësojnë nevojat dhe interesat e tyre;</p> <p>b. shpjegon se si njerëzit me prejardhje të ndryshme kulturore ose për ndryshime të tjera interpretojnë informacionet dhe përvojat;</p> <p>c. shpjegon si ndikon tradita kulturore në zhvillimin dhe tejçimin e kulturës;</p> <p>d. shpjegon pse individë të ndryshëm reagojnë në mënyra të ndryshme mbi bazën e pikëpamjeve, vlerave dhe bindjeve të tyre;</p> <p>e. përshkruan ndikimin dhe bashkëveprimin e diversitetit kulturor si dhe të kohezionit social brenda dhe ndërmjet grupeve.</p>
---	---	--

TEMATIKA: KOHA, VAZHDIMËSIA, NDRYSHIMI

Përshkrimi i kompetencës në lidhje me këtë tematikë:

Në fund të klasës V, nga nxënësi pritet të jetë i aftë të demonstrojë aftësi për të përdorur terminologjinë dhe konceptet e duhura si: kohë e shkuar, e tashme, e ardhme dhe njëherë e një kohë; të lexojë dhe të ndërtojë planifikime të thjeshta kohore; të identifikojë shembuj të marrëdhënieve shkak-pasojë nga jeta e përditshme; të krahasojë dhe të dallojë ndryshimet ndërmjet shpjegimeve për ngjarje, njerëz, vende ose situata të shkuara duke nxjerrë në pah se si ato kanë kontribuar për të kuptuarin e së kaluarës; të identifikojë dhe të përdorë burime të ndryshme për të kuptuar dhe rindërtuar të kaluarën si dokumente, letra, ditare, harta, libra, fotografi etj.; të demonstrojë të kuptuarit e faktit që njerëzit, në kohë dhe në vende të ndryshme, e shikojnë botën në mënyra dhe pamje të ndryshme; të përdorin njohuritë për fakte ose koncepte të marra nga historia, bashkë me elementët e hulumtimit historik, për të folur për vendimmarrjet dhe veprimet e ndërmarra në lidhje me çështjet publike në zonën ku jeton.

Niveli 2	Niveli 3	Niveli 4
<p>Nxënësi:</p> <p>a. tregon sesi ndryshimet ndikojnë jetën e tij, të njerëzve të tjerë dhe të komunitetit;</p> <p>b. dallon periudhat e ndryshme të jetës së tij dhe të njerëzve të tjerë duke i parë në të kaluarën dhe të sotmen;</p>	<p>Nxënësi:</p> <p>a. përshkruan ndryshimet që kanë ndodhur dhe të krahasojë tiparet e periudhave të ndryshme historike me të sotmen;</p> <p>b. krahason ndryshimet që ka pësuar ai vetë ose njerëzit e tjerë duke iu referuar</p>	<p>Nxënësi:</p> <p>a. dallon, në komunitetin lokal, se cilat janë gjërat që ndryshojnë më shpejt dhe cilat janë ato që tregojnë vazhdimësi;</p> <p>b. klasifikon ndryshimet nga e kaluara në të sotmen në fusha të ndryshme të zhvillimit të shoqërisë,</p>

<p>c. përshkruan matjen e kohës duke përdorur kalendarin, orën etj.</p> <p>d. jep shembuj të thjeshtë të vazhdimësisë kohore nëpërmjet sekuencave historike duke përdorur objekte, foto etj.;</p> <p>e. jep shembuj të thjeshtë të shkakut dhe pasojës nga jeta e tij.</p>	<p>kujtimeve, fotove, filmave dhe dokumenteve të tjera;</p> <p>c. përdor një fjalor të përshtatshëm të kohës në lidhje me datat dhe termat historike të tillë si psh. shekulli;</p> <p>d. i referohet moshës së njerëzve, vendeve dhe objekteve në një shumëllojshmëri kontekstesh historike;</p> <p>e. jep shembuj të lidhjes shkak- pasojë nga shoqëria ose natyra;</p>	<p>c. përdor të dhënat e burimeve të tjera të informacionit për të treguar historikun dhe trashëgiminë kulturore të komunitetit lokal;</p> <p>d. vlerëson rrethanat e shkakut dhe pasojës në situatat e jetës së përditshme;</p> <p>e. tregon rëndësinë e lidhjes shkak-pasojë në kuptimin e ngjarjeve të ndryshme</p>
--	---	--

TEMATIKA: NJERËZ, VENDE, MJEDISE

Përshkrimi i kompetencës në lidhje me këtë tematikë:

Në fund të klasës V, nga nxënësi pritet të jetë i aftë të dallojë, të përdorë dhe të interpretojë përgjegjësitë që kanë njerëzit ndaj mjedisit përreth si dhe ndryshimeve në botë, duke pasur parasysh njohjen e hartave, globit, si dhe fotografive të ndryshme; të përdorë burime të përshtatshme, burime të dhënash etj. që të gjenerojë, të përpunojë dhe të interpretojë informacionin e marrë; të përshkruajë se si njerëzit krijojnë vendet e tyre

të banimit, si ata reflektojnë idetë e tyre, si krijojnë kulturën, personalitetin, si shprehin dëshirat dhe prezantojnë nevojat që ata kanë si: shtëpi, kënd lojërash, shkollë etj.; të shqyrtojë ndërveprimin e qenieve njerëzore me mjediset e tyre fizike si: përdorimi i tokës, ndërtimi i qyteteve, ndryshimet në ekosisteme që lidhen me përzgjedhjen e zonave dhe rajoneve të banimit; të vëzhgojë dhe të shpjegojë rreth rezultateve sociale dhe ekonomike të ndryshimeve mjedisore dhe krizave të ndryshme që rezultojnë nga fenomene të tilla si përmbytjet, thatësitat dhe stuhitë etj.; të eksplorojë rrugët dhe veçoritë e botës fizike, duke shpjeguar se si ato kanë ndryshuar në kohë në zonën ku ata jetojnë e më gjerë dhe, si këto ndryshime në kohë, mund të jenë lidhur me njëra-tjetrën.

Niveli 2	Niveli 3	Niveli 4
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> a. përshkruan njerëz, ngjarje të komunitetit lokal në të kaluarën; b. dallon bashkëveprimin e njerëzve me natyrën, mënyrat e ndarjes së burimeve natyrore në shtëpi dhe në komunitetin lokal; c. flet për rëndësinë dhe rolin e familjeve dhe të komuniteteve në zhvillimin dhe mbrojtjen e mjedisit; d. dallon nevojat e grupeve sociale dhe rrugët sesi ato i përmbushin këto nevoja; 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> a. dallon karakteristikat e njerëzve, ngjarjeve dhe shoqërive lokale në të kaluarën; b. krahason bashkëveprimin e njerëzve me natyrën, mënyrat e shpërndarjes së burimeve natyrore nga një periudhë historike në tjetrën; c. përdor shembuj konkretë për të treguar rolin e njeriut dhe të komuniteteve për zhvillimin dhe mbrojtjen e mjedisit; d. dallon nevojat e ndryshme që kanë njerëzit dhe mënyrat sesi familjet dhe 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> a. përshkruan vlerat dhe qëndrimet që kanë karakterizuar shoqërinë njerëzore në të kaluarën; b. shpjegon sesi ngjarjet dhe vendimet aktuale ndikojnë pozitivisht ose negativisht në zhvillimet ose jo të vendeve të ndryshme dhe mjedisit; c. tregon disa nga zakonet më tipike të komunitetit lokal pas identifikimit të tyre në një proces sistematik kërkimi; d. krahason mënyrat sesi përmbushen nevojat e njerëzve në vendin tonë dhe në botë;

<p>e. jep shembuj të rregullave, të të drejtave dhe përgjegjësive që shërbejnë për ruajtjen e vendeve dhe të mjediseve;</p> <p>f. rendit disa mjete të komunikacionit, shenja të trafikut dhe rregulla të qarkullimit rrugor;</p> <p>g. jep gjykimet e para mbi vendimmarrjet përkundrejt mjedisit ;</p>	<p>komunitetet pranojnë përgjegjësitë për t'i përmbushur ato;</p> <p>e. tregon si dhe pse janë bërë rregullat për mbrojtjen e mjedisit dhe pasojat e mospërmbushjes së përgjegjësive nga ana e njerëzve dhe komunitetit;</p> <p>f. tregon funksionet e tabelave të ndryshme të qarkullimit rrugor;</p> <p>g. jep shembuj sesi individët mund të marrin pjesë në vendimmarrje në familje, shkollë , kohën e lirë për të mbrojtur mjedisin.</p>	<p>e. sugjeron rregulla për mbrojtjen e mjedisit nga ana e komunitetit;</p> <p>f. krahason qarkullimin rrugor të zonave rurale dhe ato urbane;</p> <p>g. merr pjesë në vendimmarrje për veprime të thjeshta në mbrojtjen e mjedisit në shkollën, lagjen apo fshatin e tij.</p>
--	---	--

TEMATIKA: ZHVILLIMI INDIVIDUAL DHE IDENTITETI

Përshkrimi i kompetencës:

Në fund të klasës V, nga nxënësi pritet të jetë i aftë: të dallojë ndryshimet personale në kohë, të tilla që kanë lidhje me zhvillimin fizik dhe interesat vetiake, personale; të dallojë lidhjet personale të vendit ku jeton ose të vendit të preferuar të tij, duke i shoqëruar drejtpërdrejt me mjedisin rrethues; të dallojë veçoritë e përbashkëta të një familje-bërthamë dhe të një familjeje të zgjeruar; të prezantojë të nxënit dhe zhvillimin fizik të tij, si dhe sjelljet e të vepruarit personal; të identifikojë dhe të dallojë rrugët e krijimit të familjeve, të grupeve, si dhe influencat e komunitetit në jetën ditore individuale dhe zgjedhjet personale të njerëzve; të eksplorojë faktorët që kontribuojnë drejt krijimit të një identiteti personal përmes interesave, kapaciteteve dhe perceptimeve vetiake; të analizojë një ngjarje të hollësishme përmes identifikimit të arsytimeve

individuale, duke iu përgjigjur kësaj situatë në rrugë të ndryshme; të punojë i pavarur dhe bashkërisht në grupe për realizimin e qëllimeve të vëna.

Niveli 2	Niveli 3	Niveli 4
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> a. pranon veten si individ unik; b. identifikon aftësi dhe shprehi individuale; c. dallon ndryshimet tek vetja; d. dallon dhe shpreh gjendjen dhe ndjenjat e tij; 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> a. identifikon vlera dhe qëndrime të tij; b. shpreh mendimin e tij për aftësitë dhe gjykimet e veta; c. bën dallimin ndërmjet ndryshimit dhe zhvillimit; d. përshkruan interesat e veta dhe të grupit e të lidhet me to; 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> a. shpreh respektin ndaj vetes përmes vlerësimit kritik të situatës; b. vlerëson aftësitë dhe qëndrimet e tij; c. pranon ndryshimin që sjell ndryshim tek vetja dhe tek grupi mbi bazën e të mirës së përbashkët; d. mbron interesat e veta dhe të grupit;

TEMATIKA: INDIVIDËT, GRUPET, INSTITUCIONET

Përshkrimi i kompetencës në lidhje me këtë tematikë:

Në fund të klasës V nga nxënësi pritet të jetë i aftë: të identifikojë rolet si shembull i sjelljeve të të nxënësve të tij në situatat e grupit: si nxënës, anëtar familjeje, anëtar i barabartë i grupit në një lojë ose anëtar i klubeve të ndryshme shkollore; të japë shembuj të grupeve dhe të shpjegojë ndikimet institucionale si ligjet, rregullat si dhe ndikimet e moshatarëve të njerëzve, ngjarjet dhe elementet kulturore p.sh.: rregullat e klasës, të shkollës, të komunitetit; të thotë emra të institucioneve të ndryshme, si dhe të dallojë ndërveprimet e njerëzve me to si shkolla, familja,

komuniteti, pushtetin vendor dhe ai qëndror; të identifikojë dhe të shqyrtojë shembuj të acarimit midis grupeve, individëve ose institucioneve, të cilat i përkasin më shumë një grupi që mund të shkaktojë një konflikt të brendshëm; të identifikojë dhe të shqyrtojë shembuj të acarimit ndërmjet besimit individual dhe ligjeve, rregullave dhe praktikave qeverisëse në shkollë, familje dhe komunitet; të japë shembuj të rolit të institucioneve (shkollë, familje, komunitet, pushtet lokal) në përkrahjen që ata i japin të dy çështjeve: vazhdimësisë dhe ndryshimit; të prezantojë grupe dhe institucione që punojnë për plotësimin e nevojave individuale, si dhe për sigurimin e të mirave të përbashkëta, duke identifikuar edhe shembuj për rastet kur këto grupe dhe institucione nuk punojnë në këtë drejtim

Niveli 2	Niveli 3	Niveli 4
